



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 853 Prot.

Tiranë, më 03.11.2014

UDHËZIM

Nr. 54, datë 03.11.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 43, DATË 15.10.2014 "PËR
PROCEDURËN E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E
STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË, TË OFRUARA NGA
INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË, SI DHE PËR TRANSFERIMIN
E STUDIMEVE NË KËTO INSTITUCIONE PËR VITIN AKADEMIK 2014 – 2015**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 33, 34 dhe 35 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pika 3 e Udhëzimit nr. 43, datë 15.10.2014, ndryshon si më poshtë:

"3. Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të parë, programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, programet e studimit të ciklit të dytë, si dhe për transferimin e studimeve, për vitin akademik 2014-2015, në institucionet private të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, të kryhet deri më datën 12 Nëntor 2014, dhe për programet e studimeve të ciklit të dytë, brenda datës 24 Nëntor 2014".

2. Pika 5 e udhëzimit, ndryshon si më poshtë:

"5. IAL - të private i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), listën e studentëve të regjistruar në ciklin e parë të studimeve dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, brenda datës 17 Nëntor 2014 dhe listën e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, brenda datës 27 Nëntor 2014, në formë shkresore dhe elektronike, në format excel, në CD. Pas këtyre datave AKP-ja nuk do të pranojë lista shtesë të studentëve për t'u pajisur me numrin e matrikullimit dhe listat e paraqitura nuk do të merren në shqyrtim nga AKP. AKP-ja, respektivisht, brenda datës 17 Dhjetor 2014 dhe 29 Dhjetor 2014, iu dërgon IAL-ve private listën me numrat e matrikullimit të studentëve. IAL-të private çregjistrojnë studentët e papajisur me numër

matrikullimi, si dhe ia komunikojnë çregjistrimin AKP-së brenda 10 ditëve nga marrja e komunikimit zyrtar nga AKP me listat me numrat e matrikullimit.”.

3. Pika 6 e udhëzimit, ndryshon si më poshtë:

“6. IAL - të private, deri në datën 31 Dhjetor 2014, dërgojnë zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të dhënat mbi regjistrimet dhe transferimet e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në formatet e kërkuara sipas Udhëzimit Nr. 9, datë 25.02.2010 “Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore.”.

4. Germat “a” dhe “b” të pikës 9 të udhëzimit, ndryshojnë si më poshtë:

“a. Kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse ose me vërtetimin përkatës, sipas përcaktimeve në pikën 11 të këtij udhëzimi, në një program të ciklit të parë “Bachelor” ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, i cili rezulton i akredituar në momentin e diplomimit të studentit;
b. janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë Bachelor ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS ose janë në proces njësimi.”.

5. Pika 11 e udhëzimit, ndryshon si më poshtë:

“11. Për të realizuar aplikimin, kandidati që regjistrohet në ciklin e dytë të studimeve duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Dokumentacionin e parashikuar në pikën 10 të këtij Udhëzimi;*
- b. Fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë;*
- c. Për kandidatët që kanë përfunduar studimet në IAL-të publike, në mungesë të diplomës, IAL-të pajisin kandidatin me një vërtetim që provon mbarimin e studimeve konform ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe lejon regjistrimin në ciklin e dytë të studimeve. Kandidati paraqet vërtetimin në IAL-në ku kërkon të regjistrohet sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim, dhe brenda 6 muajve dorëzon fotokopjen e njësuar me origjinalin të kartonit të diplomës, sipas përcaktimeve në pikën “b” të këtij neni;*
- d. Për kandidatët që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, vërtetimin e njësimin në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MAS, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës. Në rast se nuk janë përfunduar procedurat e njësimin, kandidati dorëzon një vërtetim që konfirmon dorëzimin në MAS të dokumentacionit të parashikuar për njësimin e diplomës së ciklit të parë, dhe brenda 45 ditëve dorëzon vërtetimin përkatës të njësimin.”.*

6. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve si edhe institucionet private të arsimit të lartë.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

LINDITA NIKOLLA



MINISTËR

